



BOLLETTINO

SALA STAMPA DELLA SANTA SEDE

Nr. 0170

E premte, 20.03.2020

Dekreti i Penitencerisë Apostolike në lidhje me dhënien e Ndjesëve të veçanta besimtarëve në situatën aktuale të pandemisë, 20.03.2020

PENITENCERIA APOSTOLIKE

DEKRET

U jepet dhurata e Ndjesëve të veçanta besimtarëve të infektuar nga virusi Covid-19, përgjithësisht i quajtur Coronavirus, si dhe punonjësve shëndetësorë, familjarëve dhe të gjithë atyre që me çfarëdo mënyre, edhe me lutje, kujdesen për ta.

«Në shpresë jini të gëzueshëm, në vështirësi të durueshëm, në lutje të qëndrueshëm!» (*Rom* 12,12). Fjalët e shkruara nga shën Pali drejtuar Kishës së Romës tingëllojnë përgjatë gjithë historisë së Kishës dhe orientojnë gjykimin e besimtarëve përballë çdo vuajtjeje, sëmundjeje dhe fatkeqësie.

Momenti i tanishëm ku gjendet i gjithë njerëzimi, i kërcënuar nga një virus i padukshëm dhe i rrezikshëm, që tashmë prej kohësh ka hyrë dhunshëm në jetën e të gjithëve, ritmohet ditë pas dite nga frika të ankthshme, pasiguri të reja dhe sidomos nga një vuajtje e përhapur fizike e morale.

Kisha, sipas shembullit të Mësuesit Hyjnor, gjithmonë e ka pasur për zemër mbështetjen ndaj të sëmurëve. Siç ka thënë shën Gjon Pali II, vlera e vuajtjes njerëzore është e dyfishtë: «Është *mbinatyrore*, sepse i ka rrënjët në misterin hyjnor të shëlbimit të botës, dhe është, po ashtu, thellësisht *njerëzore*, sepse në të njeriu rigjen vetveten, njerëzimin e vet, dinjitetin e vet, misionin e vet» (*Let. Ap. Salvifici doloris*, 31).

Edhe papa Françesku, gjatë këtyre ditëve të fundit, ka dëftuar afërsinë e vet atërore dhe ka përtërirë ftesën për t'u lutur pareshtur për të sëmurët nga Coronavirus.

Me qëllim që të gjithë ata që vuajnë për shkak të Covid-19, pikërisht në misterin e kësaj vuajtjeje të mund të rizbulojnë «të njëjtën vuajtje shëlbuese të Krishtit» (*ibid.*, 30), kjo Penitenceri Apostolike, *ex auctoritate Summi Pontificis*, duke u mbështetur në fjalën e Krishtit Zot dhe duke e konsideruar me shpirt feje epideminë aktuale, që duhet jetuar në stilin e kthimit personal, jep dhuratën e Ndjesëve me përmbajtjen e këtij dokumenti.

U jepet *Ndjesa e plotë* besimtarëve të infektuar nga Coronavirus, të nënshtruar regjimit të karantinës me dispozitë të autoritetit shëndetësor në spitale apo në banesat e tyre nëse, me shpirt të shkëputur nga çfarëdo mëkati, do të bashkohen shpirtërisht me anë të mjeteve të komunikimit me kremtimin e Meshës së shenjtë, me recitimin e Rruzares së shenjtë, me praktikën e përshpirtshme të *Udhës së Kryqit* ose me forma të tjera të devocionit, ose nëse, të paktën do të thonë Besojmën, Atynën dhe një lutje të përshpirtshme drejtuar së Lumes Mari Virgjër, duke e kushtuar këtë provë me shpirt feje në Hyjin dhe dashurie ndaj vëllezërve, me vullnetin për të kryer kushtet e zakonshme (rrëfimi sakramental, kungimi eukaristik dhe lutja sipas qëllimeve të Atit të Shenjtë), sapo të kënë mundësi.

Punonjësit shëndetësorë, familjarët dhe ata që, sipas shembullit të Samaritanit të Mirë, duke u përballuar me rrezikun e infektimit, ndihmojnë të sëmurët nga Coronavirus sipas fjalëve të Shëlbuesit hyjnor: «Dashuria më e madhe që ndokush mund të tregojë është: të japë jetën e vet për miqtë e vet» (*Gjn 15, 13*), do të marrin të njëjtën dhuratë të *Ndjësës së plotë* me të njëjtat kushte.

Kjo Penitenceri Apostolike, gjithashtu, u jep me kënaqësi, me të njëjtat kushte, *Ndjesën e plotë* me rastin e epidemisë aktuale botërore, edhe atyre besimtarëve që kushtojnë vizitën te i Shenjtërueshmi Sakrament, ose adhurimin eukaristik, ose leximin e Shkrimeve të Shenjta për të paktën gjysmë ore, ose recitimin e Rruzares së shenjtë, ose praktikën e përshpirtshme të *Udhës së Kryqit*, ose recitimin e Rruzares së Mëshirës hyjnore, për të kërkuar prej Hyjit të Gjithëpushtetshëm ndalimin e epidemisë, lehtësimin për ata që janë të prekur prej saj dhe shpëtimin e amshuar të atyre që Zoti i ka thirrur te vetja.

Kisha lutet për ata që gjenden në pamundësi për të marrë sakramentin e Vajimit të të sëmurëve dhe të përshtegtimin, duke ia besuar Mëshirës hyjnore të gjithë dhe secilin me anë të bashkësisë së shenjtërve dhe i jep besimtarit *Ndjesën e plotë* në fill të vdekjes, mjafton që ai të jetë i gatshëm siç duhet dhe të ketë thënë në mënyrë të zakonshme gjatë jetës ndonjë lutje (në këtë rast Kisha plotëson tre kushtet e zakonshme të kërkuara). Për marrjen e kësaj ndjese porositet përdorimi i kryqit (krh. *Enchiridion indulgentiarum*, nr. 12).

E Lumja Mari gjithmonë Virgjër, Nëna e Hyjit dhe e Kishës, Shëndeti i të sëmurëve dhe Ndihma e të krishterëve, Pajtorja jonë, e ndihmoftë njerëzimin e vuajtur, duke e larguar prej nesh të keqen e kësaj pandemie dhe duke fituar për ne çdo të mirë të nevojshme për shpëtimin dhe shenjtërimin tonë.

Ky Dekret është i vlefshëm pavarësisht prej çfarëdo dispozite të kundërt.

Dhënë në Romë, nga selia e Penitencerisë Apostolike, më 19 mars 2020.

Mauro Kard. Piacenza
Penitencieri Madhor

Krzysztof Nykiel
Regjent